

Aktualisht mban postin e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Shërbimeve në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Ka lindur në Tiranë në vitin 1966, është i martuar dhe ka dy fëmijë.

Është diplomuar për Arkitekt Urbanist pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Arkitekturës, në vitin 1989. Gjatë viteve 1999-2006 ka qenë Pedagog me kohë jo të plotë pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, në Tiranë. Gjatë periudhës 1990-2015 ka ushtruar detyrën e Specialistit, Përgjegjësit dhe Drejtorit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorrit të Këshillit të Qarkut Tiranë. Gjatë viteve 2015-2017 ka drejtuar Drejtorinë e Planifikimit Urban, të Komunës Farkë. Në vitin 2017 ka punuar si specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit Urban, Sektori i Hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në vitin 2020. Prej këtij viti ka ushtruar detyrën e specialistit në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetese, Sektori Urbanistikë, pranë Këshillit të Qarkut Tiranë. Prej 30 vjetëve është autor dhe bashkëautor i disa projekteve në fushën e urbanistikës dhe arkitekturës. Prej viti 1995 është anëtar i Shoqatës së Arkitektëve dhe Planifikuesve Shqiptarë. Në periudhën 1994-2010 ka qenë anëtar i Këshillit Teknik në Këshillin e Qarkut Tiranë dhe gjatë viteve 2002 – 2010 anëtar i KRRT, Tiranë.

Ka marrë pjesë në trajnime kombëtare e ndërkombëtare në fushën Arkitekturore dhe Urbanistike. Zotëron dy gjuhë të huaja: anglisht dhe italisht.